



PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

BASHKIA DIMAL

MESAZH NGA KRYETARJA E BASHKISË

Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2025-2027 doli si një nevojë për të planifikuar dhe vepruar më mirë dhe më me efektivitet dhe efikasitet për fuqizimin e të rinjve, që t'ju mundësojmë atyre një jetë të shëndetshme dhe të pasur sociale, kulturore dhe sportive, aftësim për jetën dhe punësim, si dhe pjesëmarrje aktive në vendim-marrjen lokale. Në këtë mënyrë, ne do të realizojmë misionin e bashkisë Dimal që *“përtej qëllimit ekonomik, synon të krijojë një mjedis shoqëror të shëndetshëm, nga i cili përfiton i gjithë komuniteti, ku e mira e përbashkët mbizotëron, ku banorët jetojnë në harmoni me burimet natyrore, hapësirat publike dhe komunitetet e tjera që e rrethojnë, sot e në vazhdim”*.

Të rinjtë janë jo vetëm e tashmja dhe e ardhmja jonë. Ata kanë talent, ide të mëdha dhe aftësi. Ata janë optimist për të ardhmen. Me energjinë dhe vitalitetin e tyre, ata i kapërcejnë shpejt problemet dhe sfidat. Ne duhet t'i mbështesim që ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Në këtë Plan, ne kemi reflektuar nevojat, prioritetet dhe ambiciet e tyre.

Plani Lokal i Veprimit për Rininë u zhvillua bazuar në një proces konsultimi që përfshiu takime në grup dhe individuale me përfaqësues të Bashkisë dhe aktorë të tjerë lokalë si dhe një anketim me të rinj nga qyteti i Urës Vajgurore dhe zonat rurale. Plani është strukturuar përreth objektivave të vendosura për secilin nga prioritetet e identifikuara— arti/kultura/sporti, pjesëmarrja në vendim-marrjen lokale, dhe punësimi dhe sipërmarrja rinore. Plani Lokal i Veprimit për Rininë thekson nevojën për të punuar së bashku me të rinjtë, aktorët lokalë qeveritarë dhe jo-qeveritarë, si dhe pushtetin qendror për një qasje të plotë dhe me rezultat.

Pani i Veprimit i Rinisë u hartua nga Bashkia Dimal në bashkëpunim me shoqatën Ura të Reja, në kuadrin e projektit “Pjesëmarrja e të rinjve në vendim-marrje, modelon të ardhmen”, mbështetur nga Agjensia Kombëtare e Rinisë – AKR.

Juliana Mema
KRYETARE



PËRMBAJTJA

1	Qëllimi, metodologjia dhe kuadri i zhvillimit të Planit Lokal të Veprimit për Rininë	4
1.1	Qëllimi dhe metodologjia	4
1.2	Kuadri i zhvillimit të Planit Lokal të Veprimit për Rininë	5
2	Bashkia Dimal	6
2.1	Zhvillimi social-ekonomik dhe demografia	6
2.2	Shërbimet dhe infrastruktura për rininë	7
2.3	Nevojat e të rinjve të Bashkisë Dimal	8
3	Çfarë do të bëjmë për të rinjtë	9
3.1	Çfarë kërkojnë të rinjtë	9
3.2	Çfarë mendojnë përfaqësuesit e shërbimeve publike për të rinjtë	11
3.3	Vizioni dhe misioni i Bashkisë Dimal për të rinjtë	12
3.4	Prioritetet, qëllimet, objektivat dhe masat kryesore	13
	Prioriteti 1: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale & mendore e të rinjve.	
	Prioriteti 2: Fuqizimi dhe organizimi rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore.	
	Prioriteti 3: Aftësimi dhe punësimi i të rinjve.	

PRIORITETET TONA:

Mirëqenia aktive fizike dhe mendore e të rinjve



Sigurimi i kushteve të nevojshme për një jetë aktive, të shëndetshme fizike, sociale dhe mendore e të rinjve të Bashkisë Dimal.

Organizimi, fuqizimi dhe pjesëmarrja rinore



Rritja e angazhimit qytetar të të rinjve në shkollë, komunitet, bashki.

Aftësimi dhe punësimi rinor



Të rrisim mundësitë e të rinjve për punësim dhe vetë-punësim në bashkinë Dimal.

1. QËLLIMI, METODOLOGJIA DHE KUADRI I ZHVILLIMIT TË PLVR

1.1. Qëllimi dhe metodologjia

Plani Lokal i Veprimit për Rininë është një instrument udhëheqës për Bashkinë në punën e saj me dhe për të rinjtë, komunitetin, ofruesit e shërbimeve për të rinjtë dhe palët e tjera të interesuara për të plotësuar nevojat e të rinjve të Dimalit dhe për të krijuar një qytet miqësor kundrejt të rinjve. Objektivat e Planit Lokal të Veprimit për Rininë janë:

- ✓ Identifikimi i nevojave të të rinjve të Bashkisë Dimal lidhur me shërbimet, mjediset dhe programet.
- ✓ Adresimi i nevojave të të rinjve në fushat prioritare duke vendosur objektiva specifike ambicioze dhe të arritshme si dhe masa konkrete për arritjen e tyre.
- ✓ Identifikimi i mundësive të koordinimit dhe bashkëpunimit me aktorët e tjerë lokalë, qeveritarë dhe jo-qeveritarë, si dhe pushtetin qendror për adresimin e nevojave të të rinjve.

Ky Plan është realizuar me përfshirjen e gjerë të të rinjve dhe me pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë që marrin pjesë në realizimin e shërbimeve për rininë. Metodologjia e përdorur për zhvillimin e Planit përfshin rishikimin e dokumenteve, shqyrtimin e modeleve të suksesshme të zhvilluar nga bashki dhe aktorë të tjerë, intervista individuale, grupe fokus, si dhe një anketë me të rinjtë.

Faza 1: Shqyrtimi dokuemnteve ekzistues. U shqyrtua legjislacioni aktual, veçanërisht Ligjet “Për rininë” dhe “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe strategjitë e tjera kombëtare që lidhen me rininë. U identifikuan hapat konkretë të ndërmarra nga bashkia në zbatim të legjislacionit dhe politikave kombëtare, veçanërisht Planit Lokal të Veprimit për Rininë 2020-2023 i Bashkisë Dimal.

Faza 2: Përfshirja e të rinjve për identifikimin e problemeve, shqetësimeve dhe nevojaveve të tyre. U përfshinë anëtarët e Këshillit Vendor të Rinisë dhe të rinjtë e angazhuar në aktivitetet e bashkisë dhe të organizatave të shoqërisë civile si shoqata Ura të Reja, e cila vitet e fundit ka qenë organizata më aktive në Dimal. Tre fusha prioritare u identifikuan: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale & mendore; Organizimi, fuqizimi dhe pjesëmarrja; Aftësimi dhe punësimi i të rinjve.

Faza 3: Konsultimi me strukturat e Bashkisë dhe aktorët e tjerë lokalë lidhur me problematikat për rininë dhe zgjidhjen e tyre. U identifikua gjendja ekzistuese lidhur me politikat dhe burimet lokale për plotësimin e nevojave të rinisë, mangësitë dhe potencialet.

Faza 4: Kontributi i të rinjve dhe përfaqësuesve lokalë u reflektua në draftin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë. Një draft i parë i Planit Lokal të Veprimit për Rininë u zhvillua dhe konsultua me pjesëmarrësit në planifikim.

Faza 4: Aprovimi nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak. Në këtë fazë, versioni përfundimtar i Planit Lokal të Veprimit për Rininë i është dorëzuar Kryetares së Bashkisë Dimal dhe Këshillit Bashkiak për aprovim.

Në vitin 2019, me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung dhe në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar, Bashkia Dimal (në atë kohë Bashkia Ura Vajgurore) ka hartuar Planit Lokal të Veprimit për Rininë 2020-2023. Në këtë Plan, bashkia prezantoi ambicjet e saj për të ndërhyrë thellë e në mënyrë gjithëpërfshirëse për transformimin e realitetit ku jetojnë, studiojnë dhe ëndërrojnë të rinjtë e qytetit dhe zonave rurale të bashkisë. Plani synoi nxitjen e zhvillimit të një rinie të kulturuar dhe të shëndetshme, aktive në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor. Plani Lokal i veprimit për Rininë 2025-2027, shënon vazhdimësinë e përpjekjeve të bashkisë për rininë.

Procesi u lehtësua nga ekspertët e angazhuar nga projekti “Pjesëmarrja e të rinjve në vendim-marrje, modelon të ardhmen”, mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe zbatuar nga shoqata Ura të Reja.

1.2. Kuadri i zhvillimit të PLVR

Plani Lokal i Veprimit për Rininë është në zbatim të drejtpërdrejtë të Ligjit “Për Rininë” (75/2019) dhe Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022-2029.

Ligji “Për Rininë” ngarkon përgjegjësi specifike për njësitë e qeverisjes vendore të cilat, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për:

- pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
- krijimin e këshillit vendor të rinisë;
- organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve;
- organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;
- nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
- financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;
- krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
- parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;
- mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.

Një objektivë e **Strategjisë Kombëtare të Rinisë** është që “të rinjtë janë të mirëinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike” (Objektivi Specifik 1.1).

Në këtë kontekst duhet të forcohen mekanizmat (në nivel qendror dhe vendor) për të garantuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje

Gjithashtu Strategjia kërkon që «të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore, sociale, fizike dhe seksuale» (Objektivi Specifik 3.2).

Objektivi Specifik 3.3 thekson se «Të rejat dhe të rinjtë të mbështeten në përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri duke pasur mundësi për strehim dhe argëtim (në kulturë, art dhe sport)», nëpërmjet ndërtimit, riparimit dhe rinovimit të hapësirave publike të projektuara për të rinjtë me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta takimi edhe në kohën e lirë.

2. BASHKIA DIMAL

2.1. Zhvillimi social-ekonomik dhe demografik

Bashkia Dimal bën pjesë në Qarkun e Beratit, e krijuar me reformën e re territoriale. Bashkia Dimal shtrihet në Krahinën Malore të Shqipërisë Jugore dhe pjesërisht në Ultësirën Perëndimore. Shtrirja në dy krahina të ndryshme fiziko-gjeografike, ndikon në ndryshueshmërinë e relievit të territorit dhe të kushteve fiziko-gjeografike.

Bashkia Dimal ka një sipërfaqe prej 156.56 km² dhe kufizohet me Bashkinë Lushnje, me Bashkinë Kuçovë, me Bashkinë Dimal dhe Bashkinë e Roskovecit. Kjo Bashki ka në përbërjen e saj 1 qytet dhe 33 fshatra. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Dimal, përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ qytetin e Urës Vajgurore dhe njësitë administrative Poshnje, Kutalli dhe Cukalat. Sipas Censit 2023, bashkia Dimal ka 28,135 banorë (14,347 femra ose 0.51%). Ndërsa sipas Regjistrat Civil ajo numëron një popullsi prej 40,168 banorë. Kutallia është njësia administrative me numrin më të madh të banorëve me 9,643 banorë, e ndjekur nga Poshnja dhe Ura Vajgurore me respektivisht 7,375 dhe 7,232 banorë.

Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Urës Vajgurore. Qyteti është i ndërtuar midis dy anëve të lumit Osum, në një pozicion gjeografik si vend kalimi dhe lidhës të qarkun të Beratit me Shqipërinë Qendrore, Veriore, Jugore dhe Juglindore.

Territori i Bashkisë është fushor (46 %) e kodrinor (54 %) sidomos në pjesën perëndimore të saj. Rajoni karakterizohet nga një klimë mesdhetare tipike me verë të nxehtë dhe dimër të butë e pjesërisht të lagësht. Dimali ka rreth 270 ditë me diell. Tokat e zonës ku shtrihet qyteti Ura Vajgurore dhe fshatrat përreth janë shumë pjellore, përgjithësisht aluvionale. Ndërsa në zonën më kodrinore, dominojnë tokat e kafenjta. Bashkia shtrihet në një zonë të pasur edhe me burime të rëndësishme guri.

Pozita gjeografike dhe kushtet klimatiko-tokësore të favorshme përbëjnë, një avantazh për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Klima favorizon zhvillimin e agro-biznesit, i cili luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të bashkisë.

Bashkia Dimal klasifikohet si një bashki rurale, me drejtim ekonomik bujqësor e blegtoral. Me ndarjen e re administrative, Bashkia ka marrë një profil të rëndësishëm bujqësor, të orientuar sidomos në frutikulturë me prodhimin e ullirit, por nuk mbetet pas dhe blegtoria, drithërat dhe perimet, si dhe shumë foragjere. Veçanërisht Komuna Kutalli është e njohur në rang kombëtar për kultivimin dhe hershmërinë e perimeve në serat pa ngrohje. Burimet kryesore të të ardhurave për banorët e kësaj zone bazohen te fermtat bujqësore, përpunimi agro-industrial, plantacionet me ullinj, dru frutorë dhe vreshta, perimet, blegtoria, si dhe përpunimi i produkteve të qumështit dhe mishit.

Zona është e njohur edhe për minierat sipërfaqësore të gurit dhe përpunimin e gurit në granit dhe gëlqere, duke u quajtur edhe “gurorja” e Shqipërisë për shkak të numrit të madh të shoqërive private që kryejnë aktivitet në këtë fushë. Shfrytëzimi i gurore ka shkaktuar probleme mjedisore për qytetin e Urës Vajgurore dhe fshatrat rrotull tij.

Nivel arsimor i popullsisë është relativisht i ulët--69.1% e popullsisë ka arsim fillor 8 ose 9 vjeçar dhe vetëm 22.1% ka arsimin e mesëm (INSTAT, Census 2011).

Shërbimi parësor shëndetësor në Bashkinë Dimal mbulohet nga 9 qendra shëndetësore dhe 29 ambulanca. Sa i takon nivelit të përgjithshëm shëndetësor të popullsisë, ai paraqitet i mirë. Gjithsesi prania e guroreve sjell shqetësim të vazhdueshëm në shëndetin e të punësuarve në këtë sektor dhe banorëve të zonave afër saj.

Sektori kryesor i punësimit është bujqësia. Punësimi sipas aktivitetit ekonomik në Bashkinë Dimal, është rreth 67% në bujqësi, 22% në shërbime dhe 11% në industri. (INSTAT 2023/). Tendencat e punësimit dëshmojnë për një ekonomi thellësisht agrare në njësini administrative Kutalli dhe një ekonomi më të diversifikuar, urbane, në qytetin e Urës Vajgurore.

Ekonomia e bashkisë ka kapacitet të jetë aglomeruese, pra të mbledhë të punësuar nga vende të tjera dhe të mos humbasë fuqi punëtore. Numri i të punësuarëve sipas sektorëve në vitin 2016 ishte rreth 6,600 njerez në sektorin privat dhe 560 në sektorin publik. Ndërsa numri i të papunëve të regjistruar si PuPa ishte 1,496 nga të cilët 935 ose 62.5% gra dhe vajza. Numri i punëkërkesëve të papunë ka pasur një tendencë rritje.

2.2. Shërbimet dhe infrastruktura për rininë

Një ndër Objektivat Strategjik të Bashkisë Dimal, i artikuluar edhe në Planin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, është “Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor”. Ndërmjet të tjerave, kjo do të arrihet nëpërmjet: Sigurimit të një shpërndarjeje dhe përdorimi me efektivitet të burimeve; Rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së komunitetit në buxhetim dhe llogaridhënie; Përmirësimit të aksesit në zonat rurale për zbutjen e pabarazive dhe ofrimin e shërbimeve administrative në të gjithë territorin e Bashkisë; Integrimin e brezave të rinj në ekonomi, dhe krijimin e mundësive për iniciativat në kuadër të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; si dhe Forcimit të kapaciteteve të administratës publike, përmes trajnimeve të vazhdueshme profesionale.

Për vitin 2025, shpenzimet kapitale (aktive të trupëzuara) janë parashikuar të zënë 26% të totalit të shpenzimeve. Në kuadrin e zhvillimit të komunitetit (nënfunkcioni 062), parashikohet planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin. Në kuadrin e shërbimeve kulturore (nënfunkcioni 082) parashikohen organizimi, mbështetja e ngjarjeve kulturore dhe mbrojtja dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore. Në kuadër të mbështetjes për familjet dhe fëmijët, të moshuarit, sëmundjet dhe paaftësia (nënfunkcioni 104), parashikohen edhe ofrimi i shërbimeve dhe mallrave për familjet, të rinjtë ose fëmijët (qendra pushimi ose zbavitjeje), administimi dhe mirëmbajtja e qendrës

komunitare për trajtimin e fëmijëve me aftësi ndryshe, pagesa për grupe pjesë në forcën e punës që marrin pjesë në skemat e trajnimit që kanë për qëllim të zhvillojnë potencialin e tyre për punësim, trajnim profesional për personat pa punë, etj.

Bashkia Dimal është e varur në një masë të konsiderueshme nga aktorët e tjerë për realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me fuqizimin dhe pjesëmarrjen qytetare, mirëqenien fizike dhe mendore, apo aftësimin dhe punësimin e të rinjve. Të ardhurat nga transfertat e kushtëzuar dhe e pakushtëzuar mbulojnë pothuaj gjysmën e shpenzimeve të bashkisë për realizimin e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara. Të ardhurat e veta të programuara për buxhetin e bashkisë për vitin 2025 janë 277,881 mijë lekë, ose 49.7% të të ardhurave dhe 51% të shpenzimeve të planifikuara që janë 543,842 mijë lekë. Varësia nga pushteti qendror dhe aktorët e tjerë vështirëson zhvillimin dhe financimin e politikave të reja nga ana e bashkisë dhe rritjen e shpenzimeve për kulturën dhe rininë.

Bashkia bashkëpunon me donatorë të ndryshëm të vendit dhe të huaj për realizimin e aktiviteteve të ndryshme si UNDP, etj. Bashkia Dimal koordinon dhe bashkëpunon me organizatat dhe projektet jo-fitimprurëse për realizimin e aktiviteteve në territorin e Bashkisë. Bashkia ka bashkëpunuar me organizatat “Ura të Reja” dhe “Youth of Ura” për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme për të rinjtë.

Bashkia nuk ka një strukturë specifike që merret me rininë, por ka adresuar shqetësimet e të rinjve në kuadrin e fushave të ndryshme prioritare të bashkisë (shërbimet sociale, arti, kultura dhe sporti, zhvillimi ekonomik, etj).

Sipas organogramës së Bashkisë Dimal, strukturat që lidhen direkt ose indirekt me ndërhyrjet për të rinjtë përfshijnë: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, e cila ka në përbërjen e saj, specilistët e Ndhmës Ekonomike dhe Specialistin e Mbrojtjes Fëminore; dhe Sektori për Arsimin, Kulturën, Sportin, i cili ka në përbërjen e tij specialistin e sportit dhe mirëmbajtësit e terreneve sportive.

2.3. Nevojat e të rinjve në bashkinë Dimal

Në kuadrin e zhvillimit të Planit, u administrua një pyetësor on-line me të rinj nga Bashkia Dimal si dhe u zhvilluan intervista me përfaqësues të strukturave të bashkisë që merren me rininë. Në përgjithësi, të rinjtë dhe përfaqësuesit e Bashkisë ndajnë mendimet e tyre lidhur me problemet e të rinjve në Bashkinë Dimal.

Problemet kryesore përsa i përket pjesëmarrjes dhe përfaqësimit rinor në vendim-marrjen lokale:

- Kapaciteti dhe motivimi i ulët i të rinjve për pjesëmarrje.
- Mungesa e inkurajimit dhe mbështetjes nga pushteti vendor për pjesëmarrjen e të rinjve.
- Përfaqësimi i ulët i të rinjve në politikën vendore.

Problemet kryesore përsa i përket aftësisë, punësimit dhe sipërmarrjes rinore:

- Mungesa e iniciativës tek të rinjtë.
- Mungesa e aftësive profesionale.
- Mungesa e burimeve financiare për sipërmarrjen rinore.

Problemet në fushat e mirëqenies (artit, sportit, kulturës, shëndetit):

- Mungesa e mjediseve dhe mjeteve për art, kulturë dhe sport.
- Mungesa e programeve kulturore, artistike dhe sportive.
- Mungesa e politikave lokale për mbështetjen e të rinjve në art, kulturë, sport.
- Mungesa e mbështetjes nga pushteti vendor i të rinjve të talentuar.

Lidhur me problemet në fushën e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës:

- Programi mësimor i paorientuar nga kërkesat e tregut të punës.
- Mjediset dhe pajisjet.
- Aksesit për grupet vulnerabël.

Lidhur me problemet në fushën e shërbimeve publike:

- Mungesa e informacionit për shërbimet publike ekzistuese për të rinjtë.
- Mungesa e strukturave të posaçme për trajtimin e problemeve sociale si droga, dhuna, etj.
- Mungesa e lehtësirave për të rinjtë për shërbime për shkak të grupmoshës së tyre.

Fusha prioritare për rininë për të cilat u konkludua janë:

1 Mirëqenia fizike dhe mendore e të rinjve

2 Rritja e angazhimit qytetar të të rinjve në shkollë, komunitet, bashki.

3 Aftësimi profesional dhe punësimi i të rinjve

3. ÇFARË DO TË BËJMË PËR TË RINJTË?

3.1. Çfarë kërkojnë të rinjtë?

Prioritetet dhe ndërhyrjet për mirëqenien aktive, të shëndetshme, fizike, sociale & mendore të të rinjve

Prioritetet:

- Ndërtimi, riparimi dhe rinovimi i hapësirave publike të projektuara për të rinjtë.
- Shërbime për ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik tek të rinjtë.
- Bashkëpunimi midis bashkisë dhe organizatave të shoqërisë civile për rininë.
- Parandalim i përfshirjes së të rinjve në krim, trafikim njerëzor, migrim të paligjshëm, dhunë me bazë gjinore.
- Mbrojtja dhe përfshirja sociale e të rinjve nga grupet e marginalizuara.

Ndërhyrjet e kërkuara:

- Organizimi i lojrave sportive dhe argëtuese për të rritur përfshirje sociale të të rinjve.
- Krijimi i hapësirave publike rekreative dhe sportive.
- Shpërndarje posterash që përcjellin informacion mbi mirëqenien fizike, sociale dhe mendore.
- Ndërtimi i një godine vetëm për të rinjtë në formën e një Qendre Rinore.
- Ofrimi i shërbimeve pa pagesë lidhur me mirëqenien aktive të shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore.
- Ofrimi i një psikologu/e për të rinjtë.
- Organizime kampesh verore gjatë pushimeve.
- Promovimi i të rinjve me talente.

Prioritetet dhe ndërhyrjet për organizimin, fuqizimin, dhe pjesëmarrjen rinore

Prioritetet:

- Bashkëpunimi midis bashkisë, shkollës dhe organizatave të shoqërisë civile për rininë.
- Programe/projekte rinore në të drejtat e njeriut, qeverisjen e mirë, përfshirjen, barazinë gjinore, etj.
- Masa për garantimin e pjesëmarrjes/konsultimin e të rinjve në vendim-marrje.
- Mjedis shkollor përkrahës për të gjithë dhe mbështetjet për organizimet e nxënësve.

Ndërhyrjet konkrete që kërkohen:

- Ndërtimi i një Qendre Rinore.
- Inkurajimi i të rinjve për pjesëmarrje.
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme argëtuese.
- Formimi i programeve edukuese dhe ndërgjegjëse me bazë komunitare.
- Ndërtimi i një biblioteke.
- Ofrimi i kurseve profesionale.
- Organizimi i aktiviteteve kulturore.
- Kurse për të rritur aftësitë digjitale tek të rinjtë.
- Ofrimi i mbështetjes për nxënësit dhe stafin pedagogjik.
- Organizimi i trajnimeve për rininë ku informohen në lidhje me rolin dhe ndikimin e tyre në komunitet.
- Përfshirja e të rinjve në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Prioritetet dhe ndërhyrjet për aftësimin dhe punësimin rinor

Prioritetet:

- Këshillimi i të rinjve gjatë kalimit në shkollën e mesme dhe të lartë dhe nga shkolla në punë.
- Bashkëpunimi midis bashkisë, zyrës së punës, aftësimi profesional, OSHC-ve për rininë.
- Ndërmjetësimi për punësim.
- Zhvillimi i aftësive profesionale, me theks aftësitë digjitale.
- Lehtësimi i transportit publik ndër-qytetas për të rinjtë.
- Mbështetja e sipërmarrjeve rinore

Ndërhyrjet konkrete që kërkohen:

- Organizimi i aktiviteteve si takime, trajnime, Workshop-e, seminare që kanë të bëjnë me informimin e të rinjve mbi punësimin dhe aftësimin.
- Mbështetja si ndërmjetës për punësimin e të rinjve.
- Këshillim karriere.
- Ofrim mundësie për praktika/intership-e në sektorin privat dhe publik.
- Zhvillimin e fushatave të vazhdueshme me fokus rritjen e punësimit dhe aftësive për të rinjtë.
- Ofrimi i më shumë vendeve të lira pune.
- Postimi vendeve të lira të punës ne faqen zyrtare të bashkisë.
- Ofrimi i kurseve profesionale për familjet në nevojë.
- Përdorimi i rrjeteve sociale për të informuar rreth punësimit dhe aftësimi.
- Inkurajimi i të rinjve për të punuar.

3.2. Përfaqësuesit e shërbimeve për të rinjtë

Në përgjithësi, stafi i bashkisë i përfshirë në procesin e planifikimit ndan me të rinjtë shqetësimet e tyre dhe ndërhyrjet për t'i adresuar ato.

Prioritetet dhe ndërhyrjet për mirëqenien aktive, të shëndetshme, fizike, sociale & mendore të të rinjve

Prioritetet:

- Parandalim i përfshirjes së të rinjve në krim, dhunë gjinore, trafikim njerëzor.
- Bashkëpunimi midis bashkisë dhe OSHC-të rinore/për rininë.
- Krijimi i hapësirave të sigurta, kundër krimit kibernetik dhe bullizmit online dhe shërbime për ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik tek të rinjtë.
- Parandalimi i emigrimit të parregullt dhe trafikimit të njerëzve dhe kthimi në shkollë/trajnim/punë.
- Ndërtimi, riparimi dhe rinovimi i hapësirave publike të projektuara për të rinjtë.
- Qasje të pranueshme dhe miqësore për të rinjtë në strukturat shëndetësore.
- Shërbime për ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik tek të rinjtë.

Ndërhyrjet konkrete nga Bashkia:

- Zhvillimi i aktiviteteve sociale dhe kulturore.
- Sigurimi i ambienteve dhe terreneve sportive.
- Klube sportive.
- Ndërtimi i një biblioteke dhe kinemaje.
- Konsulta falas psikologjike dhe ligjore.
- Nisma të ndryshme si pastrimi i mjedisit, mbjellje pemësh, etj.

Prioritetet dhe ndërhyrjet për organizimin, fuqizimin, dhe pjesëmarrjen rinore

Prioritetet:

- Bashkëpunimi midis bashkisë, shkollës dhe OSHC-ve rinore/për rininë.
- Zhvillimi i politikave rinore bazuar mbi analiza faktike dhe dokumentare.
- Krijimi i nje baze të dhënash statistikore dhe studimore për rininë.
- Fuqizimi i kapaciteteve të politikë-bërësve dhe nëpunësve civilë në fushën e rinisë.
- Masa për garantimin e pjesëmarrjes/konsultimin e të rinjve në vendim-marrje.
- Programe/projekte rinore në të drejtat e njeriut, qeverisjen e mirë, barazinë gjinore, etj.
- Ndërgjegjësimi politik i të rinjve, edukimi i votuesve dhe nismat e tjera ndërgjegjëse.
- Mjedis shkollor përkrahës për të gjithë dhe mbështetje për organizimet e nxënësve.

Ndërhyrjet që duhet të bëjë Bashkia janë:

- Inkurajimi i të rinjve për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme sociale.
- Pjesëmarrja e të rinjve në debate dhe konferenca rinore.
- Krijimi i Qendrës Rinore
- Klube me interesa të përbashkëta kulturore të të rinjve.
- Përfshirjen në vendimmarrje.
- Rinovim i vazhdueshëm i Këshillit Vendor për Rininë.
- Dëgjesa të ndryshme me fokus rininë dhe problemet e saj.
- Bashkëpunimi me OJF-të për të rritur pjesëmarrjen e të rinjtve duke u dhënë mundësinë për trajnime jashtë vendit.
- Pjesëmarrja gjithëpërfshirëse e të rinjve në konsultime dhe vendime që ndërmerren nga pushteti vendor për të rinjtë.

Prioritetet dhe ndërhyrjet për aftësimin dhe punësimin rinor

Prioritetet:

- Mbështetja për të rinjtë nga shtresat e marginalizuara për aftësim dhe punësim.
- Lehtësimi i transportit publik ndër-qytetas për të rinjtë.
- Bashkëpunimi midis bashkisë, zyrës së punës, aftësimin profesional, OSHC-ve për rininë.
- Shërbime inovative, miqësore dhe digjitale të këshillimit për punësim dhe orientim në karrierë.
- Këshillimi i të rinjve gjatë kalimit në shkollën e mesme dhe të lartë dhe nga shkolla në punë.
- Mbështetja e sipërmarrjeve rinore.
- Zhvillimi i aftësive digjitale në arsimin e përgj. & prof. dhe trajnimet formale dhe jo-formale.
- Ndërmjetësim për punësim.

Ndërhyrjet konkrete:

- Seanca informuese për të rinjtë lidhur me tregun e punës.
- Informim për vende të lira pune.
- Koordinimi i zyrave të punës në formim profesional.
- Kurse në programet e rehabilitimit dhe integritit të të rinjve.
- Takime të shpeshta me strukturat rinore.
- Broshura të ndryshme.
- Thirrje publike në faqen zyrtare të institucionit.
- Njoftime në televizionet lokale.
- Orientimi i të rinjve drejt këshillimit dhe orientimit të kërkesave për punë sipas aftësive.

3.3. Vizioni dhe Misioni për rininë

Vizioni i Bashkisë për të rinjtë

“E ardhmja e Bashkisë Dimal, e ndërtuar me pasion, krijimtari dhe përgjegjësi, ku të rinjtë bëjnë ndryshimin pozitiv”.

Misioni i Bashkisë për të rinjtë

“Të krijojmë një mjedis shoqëror të shëndetshëm për të rinjtë, ku ata jetojnë dhe argëtohen, aftësohen dhe punojnë, angazhohen në komunitet dhe qeverisjen vendore”.

3.4 Prioritetet, qëllimet, objektivat dhe masat kryesore.

Prioriteti 1: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale & mendore e të rinjve.

Qëllimi: Të sigurohen kushtet e nevojshme për një jetë aktive, të shëndetshme fizike, sociale dhe mendore e të rinjve të Bashkisë Dimal.

Objektiva Specifike 1.1:

Të rritet angazhimi i Bashkisë për sigurimin e kushteve të nevojshme për një jetë aktive, të shëndetshme fizike, sociale dhe mendore e të rinjve të Bashkisë Dimal.

Masat kryesore	Treguesit
1.1.1. Vlerësimi i infrastrukturës fizike së Bashkisë Dimal në funksion të realizimit të aktiviteteve sociale, artistike, kulturore, dhe sportive.	Buxheti i alokuar për përmirësimin e infrastrukturës; Ambjentet e përmirësuara qytetin e Urës Vajgurore dhe Njësitë Administrative; Qendra Rinore; Ambjentet e përmirësuara në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.
1.1.2. Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimi i mjediseve të reja, përfshirë edhe në Njësitë Administrative. Krijimi i hapësirave recreative dhe përmirësimi i qendrave sportive.	
1.1.3. Sigurimi i ambienteve dhe terreneve sportive	
1.1.4. Krijimi i një Qendre Rinore, duke krijuar aty kushtet e nevojshme për realizimin e aktiviteteve sociale, kulturore, artistike dhe sportive për të rinjtë.	
1.1.5. Krijimi i një biblioteke.	
1.1.6. Krijimi i një kinemaje.	
1.1.7. Vlerësimi i gjendjes së shkollave 9-vjeçare dhe të mesme lidhur me mjediset dhe mjetet e nevojshme për aktivitete artistike, kulturore dhe sportive.	
1.1.8. Rritja e vëmendjes mbi mjediset argetuese dhe sportive në shkolla në kuadrin e rikonstruksionit të shkollave.	
1.1.9. Përfshirja në buxhet e zërave specifik për aktivitete për rininë.	

Objektiva Specifike 1.2: Të rritet numri dhe cilësia e aktiviteteve sociale, artistike, kulturore dhe sportive për të rinjtë e bashkisë Dimal.

Masat kryesore	Treguesit
1.2.1. Krijimi i një kalendari me aktivitete, eventet dhe programet që ofrohen për rininë në Bashki.	Kalendari i aktiviteteve; Buxheti i venë në dispozicion për aktivitete sociale, artistike, kulturore dhe sportive; Numri i aktiviteteve sociale, artistike, kulturore dhe sportive; Numri i aktiviteteve sociale, artistike, kulturore dhe sportive në Njësitë Administrative; Numri i aktiviteteve mjedisore; Numri i
1.2.2. Organizime eventesh, festivalesh, koncertesh, shfaqje teatrale dhe aktiviteteve të tjera gjithëpërfshirëse artistike dhe kulturore.	
1.2.3. Aktivitete sportive/kampionate futbollit, basketbollit, volejbollit, etj. mes të rinjve të shkollave nëntë-vjeçare dhe të mesme.	

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

1.2.4.	Promovimi i të rinjve të dalluar në aktivitetet në fushën e artit, kulturës, dhe sportit.	aktiviteteve promovuese për të rinjtë e talentuar; Numri i kampeve verore.
1.2.5.	Kampe verore për të rinjtë e shkollave 9-vjecare dhe të mesme.	
1.2.6.	Klube kulturore të të rinjve me interesa të përbashkëta.	
1.2.7.	Aktivitete mjedisore (pastrimi i mjedisit, mbjellje pemësh, etj.).	
1.2.8.	Bashkëpunimi midis bashkisë dhe OSHC-të rinore/për rininë për organizimin e aktiviteteve sociale, kulturore, artistike dhe sportive për të rinjtë.	

Objektiva Specifike 1.3: Të përmirësohen shërbimet për shëndetin fizik si dhe atë mendor dhe mirëqënien emocionale.

Masat kryesore	Treguesit
1.3.1. Fushata informimi dhe ndërgjegjësimi për të rinjtë mbi shëndetin fizik dhe mendor dhe mirëqënien emocionale, në bashkëpunim me shkollat, qendrat shëndetësore dhe OSHC-të (fletë-palosje dhe postera nw letwr dhe nw formw digjitale, takime inflrmuese, etj.).	Numri i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere; Numri i aktiviteteve trajnuese; Numri i të rinjve pjesëmarrës në aktivitetet trajnuese; Numri i sesioneve të këshillimit psiko-social, ligjor dhe shëndetësor për të rinjtë; Numri i aktiviteteve në shkolla lidhur me krijimin e hapësirave të sigurta për të rinjtë, kundër krimit kibernetik; Numri i të rinjve pjesëmarrës në aktivitetet në shkolla; Numri i të rinjve nga grupet e marginalizuara pjesëmarrës në aktivitete.
1.3.2. Seminare trajnuese mbi shëndetin mendor, fizik dhe social të të rinjve.	
1.3.3. Ofrimi i këshillimit falas për të rinjtë, psikologjik, ligjor dhe shëndetësor.	
1.3.4. Krijimi i hapësirave të sigurta, kundër krimit kibernetik dhe bullizmit online dhe shërbime për ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik tek të rinjtë	
1.3.5. Aktivitete me shkollat dhe grupet rinore për të promovuar përdorimin e sigurt të teknologjisë për të rinjtë dhe prindërit.	
1.3.6. Masa për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale e të rinjve nga grupet e marginalizuara.	

Objektiva Specifike 1.4: Te rrisim koordinimin dhe bashkëpunimin me aktorët e tjerë për realizimin e projekteve dhe programeve sociale, artistike, kulturore dhe sportive.

Masat kryesore	Treguesit
2.4.1. Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse qendrore dhe lokale për adresimin e nevojave të shkollave për infrastrukture të përshtatshme.	Numri i projekteve të përbashkëta të zhvilluara dhe zbatuara; Numri i projekteve rinore të OSHC-ve; Numri i OSHC-ve me të cilat bashkëpunon Bashkia/Qendra Rinore.
2.4.2. Bashkëpunimi me qendrat shëndetësore për një qasje të pranueshme dhe miqësore për të rinjtë në strukturat shëndetësore.	
2.4.3. Shkrimi i projekt propozimeve të përbashkëta me shoqatat e shoqërisë civile që janë aktive në Bashkinë Dimal.	
2.4.4. Mbështetja e nismave të organizatave të shoqërisë civile për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve rinore.	

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

Prioriteti 2: Fuqizimi dhe organizimi rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore.

Qëllimi: Rritja e angazhimit qytetar të të rinjve në shkollë, komunitet, bashki.

Objektiva Specifike 2.1: Të rrisim angazhimin e bashkisë për fuqizimin e të rinjve dhe për të siguruar pjesëmarrjen e tyre aktive në vendim-marrjen lokale.

Masat kryesore	Treguesit
2.1.1. Fuqizimi i Këshillit Vendor për Rininë. Rinovim i vazhdueshëm i Këshillit Vendor për Rininë.	Njoftimet mbi veprimtarinë dhe arritjet e Këshillit Vendor Rinor; Baza e të dhënave statistikore për rininë; Dokumentet e politikave vendore rinore; Numri i konsultimeve me të rinjtë; Numri i aktiviteteve trajnuese për punonjësve e bashkisë; Numri i punonjësve të bashkisë të trajnuar në anagazhim rinor; Buxheti specifik i dedikuar për të rinjtë; Konsultimet me organizatat rinore për dokumentet e politikave vendore.
2.1.2. Fuqizimi i kapaciteteve të politikë-bërësve dhe nëpunësve civilë në fushën e rinisë.	
2.1.3. Krijimi i nje baze të dhënash statistikore dhe studimore për rininë.	
2.1.4. Zhvillimi i politikave vendore për rininë, në konsultim me të rinjtë, dhe me pjesëmarrjen e të gjithë struktuarve të bashkisë dhe bazuar në evidenca dhe analiza faktike.	
2.1.5. Konsultimi i të rinjve në vendim-marrje. Takime të hapura midis të rinjve dhe përfaqësuesve të pushtetit vendor. Dëgjesa të ndryshme me fokus rininë dhe problemet e saj.	
2.1.6. Organizimi i debateve dhe konferencave rinore.	
2.1.7. Mundësimi i ndjekjes së organizuar nga të rinjtë i mbledhjeve të komisioneve në Këshillin Bashkiak.	
2.1.8. Në kuadrin e krijimit të Qendrës Rinore, krijimi i hapësirave për aktivitete në fushën e fuqizimit të të rinjve për angazhim qytetar.	
2.1.9. Alokimi i një buxheti specifik për aktivitetet rinore.	

Objektiva Specifike 2.2: Të rrisim kapacitetin e të rinjve për pjesëmarrje dhe angazhim qytetar.

Masat kryesore	Treguesit
2.2.1. Aktivitete dhe fushata informimi dhe ndërgjegjësimi me të rinjtë mbi pjesëmarrjen qytetare, funksionet dhe përgjegjësitë e pushtetit vendor, nismat e Bashkisë për fuqizimin e të rinjve dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në vendim-marrjen lokale.	Numri i aktiviteteve dhe fushatave ndërgjegjësuere për të rinjtë mbi pjesëmarrjen qytetare, funksionet dhe përgjegjësitë e pushtetit vendor, nismat e Bashkisë për fuqizimin e të rinjve dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në vendim-marrjen lokale; Numri i projekteve/programeve për zhvillimin e kapaciteteve të të rinjve për pjesëmarrje në politikëbërje dhe qeverisje dhe numri i të rinjve pjesëmarrës në këto aktivitete; Projektet rinore mbi të drejtat e njeriut, qeverisjen e mire, barazinë gjinore, etj. të mbështetura nga Bashkia.
2.2.2. Informimi dhe sensibilizimi i të rinjve për rëndësinë e angazhimit social dhe pjesëmarrjen aktive në jetën e komunitetit. Ndërgjegjësimi politik i të rinjve, edukimi i votuesve dhe nismat e tjera ndërgjegjësuere.	
2.2.3. Programe për zhvillimin e kapacitetit të të rinjve në çështjet e angazhimit rinor dhe pjesëmarrjes në vendim-marrjen lokale, qeverisjen e mirë, avokim dhe lobim për adresimin e çështjeve rinore, vullnetarizëm, etj.	
2.2.4. Programe/projekte rinore në të drejtat e njeriut, qeverisjen e mirë, barazinë gjinore, etj.	
2.2.5. Programe shkëmbimi midis të rinjve nga Dimali me të rinjtë nga Bashki të tjera.	
2.2.6. Programe edukuese dhe ndërgjegjësuere me bazë komunitare.	

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

Objektiva Specifike 2.3: Të përmirësojme koordinimin dhe bashkëpunimin me aktorët e tjerë për fuqizimin dhe angazhimin rinor.

Masat kryesore	Treguesit
2.3.1. Krijimi i partneriteteve ndër-sektoriale dhe cuarja përpara e bashkëpunimit me partneret, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe projektet e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare. Konsultimi me ta për zbatimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë.	Numri i programeve motivuese për pjesëmarrjen e të rinjve në politikë-bërje dhe qeverisje; Numri i organizatave të përfshira në hartimin e buxhetit.
2.3.2. Përkrahja e organizatave rinore dhe mbështetja e tyre për realizimin e aktiviteteve rinore.	
2.3.3. Alokimi i një buxheti nga Bashkia Dimal për projekte të organizatave të shoqërisë civile që adresojnë nevojat dhe kërkesat e të rinjve të Bashkisë.	
2.3.4. Bashkëpunimi me OSHC-të për të mundësuar pjesëmarrjen e të rinjve në trajnime brenda dhe jashtë vendit.	
2.3.5. Bashkëpunimi me shkollat për krijimin e një mjedisi shkollor përkrahës për organizimet e nxënësve.	

Prioriteti 3: Aftësimi dhe punësimi i të rinjve.

Qëllimi: Të rrisim mundësitë për punësim dhe vetë-punësim të të rinjve në Dimal dhe të zbusim tendencën e largimit të tyre nga vendlindja.

Objektiva Specifike 3.1: Të rrisim informacionin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve lidhur me kërkesat e tranzicionit nga shkolla nëntë-vjecare dhe e mesme në punë.

Masat kryesore	Treguesit
3.1.1. Seminare informuese me të rinjtë mbi tranzicionin nga shkolla në punë.	Numri i seminareve informuese; Numri të rinjve pjesëmarrës në seminarin informues; Numri i sesioneve të këshillimit të karrierës; Numri i të rinjve pjesëmarrës në sesionet e këshillimit të karrierës; Numri i trajnimeve për aftësitë digjitale; Numri të rinjve pjesëmarrës në trajnimet mbi aftësitë digjitale.
3.1.2. Këshillimi karriere. Këshillim i të rinjve gjatë kalimit në shkollën e mesme dhe të lartë dhe nga shkolla në punë.	
3.1.3. Fushata informimi dhe ndërgjegjësimi drejtuar tek të rinjtë dhe prindërit mbi aftësimin dhe punësimin e të rinjve. Takime, seminare trajnuese. Përdorimi i rrjeteve sociale për të informuar rreth punësimit dhe aftësimin.	

Objektiva Specifike 3.2: Të rrisim angazhimin e bashkisë për aftësimin profesional dhe punësimin e të rinjve.

Masat kryesore	Treguesit
3.2.1. Identifikimi i të rinjve në kërkim të mundësive të formimit profesional dhe të punësimit, me fokus në të rinjtë nga grupet e marginalizuara.	Numri i trajnimeve të zhvilluara për aftësimin e të rinjve në tregun e punës; Numri i të rinjve të trajnuar; Numri i të rinjve që kryejnë praktikën profesionale në institucione dhe biznese; Një Portal funksional për punësimin e të rinjve në Bashkinë Dimal; Lehtësirat administrative të ofruara prej bashkisë për bizneset/ institucionet që punësojnë të rinj; Numri i subjekteve me marrëdhënie të formalizuara; Numri i të rinjve të punësuar.
3.2.2. Bashkëpunimi me zyrën e punës dhe qendrat e formimit profesional për regjistrimin e të rinjve në kurset profesionale për të rinjtë.	
3.2.3. Organizimi i kurseve profesionale për të rinjtë, me theks në zhvillimin e aftësive digjitale.	
3.2.4. Lehtësimi i transportit publik ndër-qytetas për të rinjtë që duan të marrin pjesë në kurset profesionale.	

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

3.2.5.	Ndërmjetësimi për zhvillimin e praktikave profesionale nga të rinjtë pranë institucioneve publike lokale dhe bizneseve lokale.	
3.2.6.	Postimi vendeve të lira të punës ne faqen zyrtare të bashkisë.	
3.2.7.	Përdorimi i rrjeteve sociale për të informuar rreth punësimit dhe aftësimin.	
3.2.8.	Mbështetja e sipërmarrjeve rinore.	

Objektiva Specifike 3.3: Të përmirësojmë koordinimin dhe bashkëpunimin me aktorët e tjerë për aftësimin dhe punësimin rinor.

Masat kryesore		Treguesit
3.3.1.	Bashkëpunimi midis bashkisë, zyrës së punës, aftësimin profesional, OSHC-ve për aftësimin, praktikat profesionale, dhe punësimin e të rinjve.	Numri i projekteve të përbashkëta të zhvilluara dhe zbatuara; Numri i projekteve rinore të OSHC-ve; Numri i OSHC-ve me të cilat bashkëpunon Bashkia/Qendra Rinore.
3.3.2.	Realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit midis Bashkisë, bizneseve dhe institucioneve të ndryshme për punësimin e të rinjve që kanë mbaruar kurset profesionale si dhe të rinjtë e tjerë.	
3.3.3.	Mbështetja e nismave të organizatave të shoqërisë civile për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve për aftësimin dhe punësimin rinor.	



PËR MË SHUMË INFORMACION

Agjencia Kombëtare e Rinisë

✉ info@rinia.gov.al

Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

✉ rinia@kryeministria.al

New Bridges

✉ uratereja@gmail.com

Bashkia Dimal

✉ info@uravajguore.gov.al

Ky botim u realizua me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, (AKR) dhe Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, (MSHRF). Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e AKR-së dhe MSHRF-së.